

Raport për vlerësimin në kuadër të procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve (Follow-Up)
për programin Bsc në “Anglisht ” ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Programi i studimit, Bsc në Anglisht është Akredituar me kusht sipas Urdhërit të MAS Nr. 437, datë 25.08.2016 “Për Akreditimin me kusht të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Anglisht” në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, të Universitetit Privat “Albanian University”.

Më datë 10.11.2016 Universiteti Privat “Albanian University”, paraqet pranë ASCAL kërkesën me shkresë Nr.390/2 prot, datë 10.11.2016 “Aplikim për fillimin e procesit të heqjes së kushteve për programet Bsc. “Anglisht” dhe Bsc. “Dizajn”. Ky aplikim nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës.

Më datë 23.01.2017 Universiteti Privat “Albanian University”, paraqet pranë ASCAL shkresën me Nr. 26 prot, datë 23.01.2017, “Dorëzim dokumentacioni”. Bashkëngjitur kësaj shkrese, Institucioni paraqet dokumentacionin dhe informacion mbi plotësimin e kushteve për programin e studimit (dosja nr. 1).

Më datë 21.03.2017 nëpërmjet sistemit AMS, i është kërkuar Institucionit plotësimi i dokumentacionit për të bërë të mundur vlerësimin teknik të programit dhe më pas vlerësimin në përmbajtje nga Eksperti. Më datë 03.05.2017 Universiteti Privat “Albanian University”, paraqet pranë ASCAL shkresën me Nr. 26/1 prot, datë 03.05.2017, “Dërgim dokumentacioni plotësues për programet në proces follow - up”. Bashkëngjitur kësaj shkrese, Institucioni paraqet dokumentacionin dhe informacion mbi plotësimin e kushteve për programin e studimit (dosja nr. 2).

Më datë 06.06.2017 u krye vizita në institucion.

Më poshtë paraqitet raporti i vlerësimit teknik dhe në përmbajtje në lidhje me shkallën e përmbushjes së kushteve të vendosura në VKA Nr. 178, datë 07.07.2016, dokumentacionin që ka paraqitur Institucioni dhe masat që ka marrë për plotësimin e kushteve. Vlerësimi i Ekspertit të Jashtëm bazohet në këtë dokumentacion dhe vizitën në Institucion.

Sipas VKA NR. 178, datë 07.07.2016, pika 2 Institucioni duhet të marrë masa të menjëhershme që brenda 6 muajve të plotësojë kushtet e vendosura.

Kushtet e vendosura në VKA Nr. 178, datë 07.07.2016	Vlerësimi Teknik	Vlerësimi i Ekspertit
<p>a. Të sigurojë që të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve të zotërojnë së paku gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Në përgjigje të këtij kushti Institucioni ka paraqitur listën e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi vetëm për semestrin e parë, ku gjithsej paraqiten 8 pedagogë. Në listën e pedagogëve citohet se: Elona Limaj ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor” më datë, 01.11.2016. Gjithashtu institucioni paraqet ngarkesën për pedagogët në listën e lartpërmendur për vitin akademik 2016-2017(semestri i parë), ku jepen të ndarë pedagogë me kohë të plotë e me kohë të pjesshme, me lëndët dhe ngarkesën përkatëse për secilin prej tyre. Në këtë dokumentacion janë paraqitur 4 staf akademik me kohë të plotë me gradën shkencore “Doktor” të cilët mbulojnë 7(shtatë) lëndë, dhe 4(katër) staf akademik me kohë të pjesshme ku 3 me gradën shkencore “Doktor” dhe 1(një) me titullin “Prof.Dr”, të cilët mbulojnë 5 lëndë.</p> <p>Koment: Sipas planit mësimor lidhur me personelin akademik përkatës në RVB ku është mbështetur edhe vlerësimi i ekspertës vërehet se 22 lëndët e këtij programi mbulohehin nga:</p> <p>5 pedagogë të brendshëm të cilët mbulonin 17 lëndë(ka pedagogë që mbulojnë 4-6 lëndë), dhe 4 pedagogë të jashtëm të cilët mbulonin 5 lëndë.Nga dokumentacioni jo i plotë rezultoi se 8 pedagogët e paraqitur mbulojnë 12 lëndë nga 22 lëndë,të cilët janë të gjithë me gradën shkencore Dr.</p>	<p>Për të vlerësuar plotësimin e kushteve për akreditim të vendosura në VKA Nr. 178, date 07.07.2016 u bë shqyrtimi i dokumentave të paraqitura në ASCAL si dhe u krye vizitë dhe takime në Institucion.</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur në dosjen e dytë të plotësuar , shqyrtimit të tyre dhe bisedës të bërë në Institucion rezultoi se lëndët e përfshira në planin mësimor për vitin akademik 2016-2017 për programin e studimit Bachelor në “Anglisht” jepen nga 10 (dhjetë) pedagogë, 9 (nëntë) prej të cilëve kanë gradën Doktor dhe 1(një) ka titullin Prof. Dr. Gjithashtu gjatë vizitës në institucion u konstatua se ishte ndryshuar raporti pedagog me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Konkretisht ishin 6(gjashtë) pedagogë me kohë të plotë, nga 10 pedagogë që angazhoheshin në mësimdhënie për këtë program studimi. Në këtë program studimi janë 22</p>

	<p><u>Referenca pika 1, 2, tek lista e dokumenteve (dosja nr.1)</u></p> <p><i>Pra sic shihet ky dokumentacion nuk është i plotë në përmbushje të këtij kushti, për të gjithë lëndët e këtij programi.</i></p> <p>Në përmbushje të këtij kushti Institucioni, në dokumentacionin plotësues ka paraqitur listën e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi për të gjithë vitin akademik 2016-2017, ku gjithsej paraqiten 10 pedagogë. Në këtë dokumentacion janë paraqitur 4 staf akademik me kohë të plotë të gjithë me gradën shkencore “Doktor” të cilët mbulojnë 12 lëndë dhe 6 staf akademik me kohë të pjesshme ku 5 janë me gradën shkencore “Doktor” dhe 1 me titullin “Prof.Dr”, të cilët mbulojnë 11 lëndë.</p> <p><u>Koment:</u></p> <p><i>Vërehet se ka pedagogë të brëndshëm me gradën Dr që mbulojnë 4-6 lëndë</i></p> <p><u>Referenca pika 1, tek lista e dokumenteve (dosja nr.2)</u></p> <p><i>Dokumentacioni i paraqitur është i përshtatshëm dhe i plotë në plotësim të këtij kushti.</i></p>	<p>lëndë plus praktika metodologjike. Staf akademik me kohë të pjesshme mbulon 6 (gjashtë) lëndë. Pjesa tjetër mbulohet nga staf akademik me kohë të plotë.</p> <p>Stafi akademik me kohë të plotë mbulon kater deri gjashte lëndë, <i>por është bërë organizimi i lëndëve sipas grupeve lëndore</i>, kështu lëndët që jep një pedagog janë vazhdim i njera tjetrës, për shembull Anglishte e folur dhe Analize teksti.</p> <p><i>Në bazë të këtyre konstatimeve dhe analizave mendoj se ky kusht plotësohet</i></p>
--	--	--



b. Të merren masa për ngritjen e laboratorit të anglishtes në funksion të programit të studimit..

Në plotësim të këtij kushti Institucioni paraqet nje relacion ku citohet se: Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes këtë vit akademik ka ngritur laboratorin e anglishtes. Laboratori është bazuar mbi shembujt e laboratorëve bashkëkohor në formën English Neë Media Centre në universitete jashtë vendit. Ky laborator përbëhet nga njëzet e pesë kompjutera me kufje, ku studentët do bëjnë si punë individuale ashtu edhe të përbashkëta të drejtuara nga kompjuteri qëndror. Për ndërtimin e këtij laboratorit institucioni deklaroi se është konsultuar me David Adamson, Profesor në Universitetin e Strasburgut, drejtues i qendrës së gjuhëve dhe laboratorëve, i cili ka shprehur dëshirën të përfshihet me leksione live, videokonferenca, bashkëbisedim me studentët, si dhe programe metodike për t'u përdorur në këtë laborator. *Gjithashtu institucioni paraqet CD me filmimet për laboratorin, ku shihet se ky laborator shfrytëzohet njëkohësisht edhe për bibliotekën on line.*

Referenca pika 3

Dokumentacioni i paraqitur është i përshtatshëm dhe i plotë në plotësim të këtij kushti.

Për të parë plotësimin e kushtit të dytë për akreditim të vendosur në VKA Nr. 178, datë 07.07.2016, pasi u shqyrtua relacioni i paraqitur në ASCAL u vizitua laboratori dhe u bisedua me personin përgjegjës, Dr. Bledar Kurti

Laboratori është në katin e dytë të selisë qendrore të Universitetit, është i pajisur me 23 kompjutera në punë. Së fundmi ishte plotësuar me kufje më të përshtatshme për realizimin e qëllimeve mësimore. Salla e kompjuterit është e bollshme e ajrosur dhe e izoluar nga zhurmat. Në të zhvillohen orë mësimore në lëndë të ndryshme që përdorin multimedia. Gjithashtu përdoret edhe për video konferenca.

Laboratori shfrytëzohet për bibliotekën online të institucionit si dhe për plotësimin e formulareve të vetvlerësimit të studenteve.

Mendoj se laboratori i plotëson nevojat e studenteve, duke u nisur dhe nga numri i tyre afërsisht 50 në çdo vit të programit.

Dokumentacioni i paraqitur nga institucioni në dosjen nr.1:

1. Pedagogët e angazhuar në programin Bachelor Anglisht vetëm për semestrin e parë.
2. Tabelën me emrat e pedagogëve me lëndën përkatëse, dhe ngarkesën për secilën lëndë.
3. Laboratori i Anglishtes

Dokumentacioni i paraqitur nga institucioni në dosjen nr.2:

1. Pedagogët e angazhuar në programin Bachelor Anglisht për të gjithë vitin akademik 2016-2017.

Konkuzion përfundimtar nga Eksperti i Vlerësimit të Jashtëm :

Konstatohet se në vazhdim të punës për plotësimin e kushteve të vendosura nga VKA Nr. 178, date 07.07.2016 , Albanian University i ka plotësuar të dy kushtet e vendosura.

- Në lidhje me kushtin e parë “ *Të sigurojë që të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve të zotërojnë së paku gradën shkencore “Doktor”, institucioni ka angazhuar 10 pedagogë gjithsej, nga të cilët 9(nëntë) mbajnë gradën Doctor dhe 1(një) Prof. Akademik.Nga i gjithë stafi akademik i programit, 6 (gjashtë) janë punonjës më kohë të plotë.*
- Në lidhje me kushtin e dytë “*Të merren masa për ngritjen e laboratorit të anglishtes në funksion të programit të studimit*”, institucioni ka ngritur një laborator funksional që i plotëson nevojat e programit si me programet ashtu edhe me kapacitetet.

Mendoj se me plotësimin e këtyre kushteve Albanian University do mund të realizojë një proces mësimor dhe kërkimor me cilësi.

Ekspert i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Elida Tabaku

